



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK
KONTRATA DHE E DREJTA KOMERCIALE - STUDIME MASTER

Tema:

“Likuidimi i shoqërive tregtare në Kosovë - Aspektet normative dhe praktike”

MENTOR:

Prof. Dr. Iur. Iset Morina LL.M.

KANDIDATE:

Jehona Gjergji

Shtator 2023

PRISHTINË, KOSOVË.

2023

ABSTRAKTI

Në Kosovë ekziston një numër i madh i shoqërive tregtare të regjistruara dhe që zhvillojnë aktivitete biznesore. Megjithatë, nga praktika gjyqësore shohim se, në gjykata, numri i kontesteve të procesit të likuidimit është kryesisht i vogël, por kohëzgjatja e përfundimit të këtij procesi është kryesisht e gjatë. Kjo përkundër se Ligji për Falimentimin është përditësuar në atë mënyrë që zhvillimi i gjithë procesit të likuidimit, dhe falimentimi në përgjithësi, janë thjeshtuar dhe ngjasojnë me zhvillimin e proceseve në fjalë në vendet e zhvilluara të Evropës.

Çështje me rëndësi është që, në Kosovë, sipas Ligjit në fuqi për Falimentim, procesit të likuidimit mund t'i nënshtrohen vetëm personat juridik që janë të regjistruar si shoqëri tregtare. Kjo nënkupton që personat fizik, që nuk janë të regjistruar si shoqëri tregtare, për dallim nga shtete të tjera siç është për shembull Gjermania, përjashtohen tërësisht nga ky proces.

Rëndësi të veçantë ka edhe objekti i procesit të likuidimit, që ndryshe quhet edhe pasuria falimentuese. Ky objekt, megjithëse dallon varësisht nga shoqëria tregtare që i nënshtrohet procesit në fjalë, duhet të jetë patjetër i ndërlidhur me veprimtarinë afariste që ka ushtruar shoqëria tregtare që është subjekt i procesit të likuidimit. Më konkretisht, objekt i likuidimit mund të jenë vetëm gjërat materiale që janë regjistruar në pronësi të debitorit dhe që janë përdorur me qëllim të zhvillimit të veprimtarive afariste të debitorit. Pra, përgjegjësia e shoqërive tregtare për përmbushje të kërkesave kreditore, gjegjësisht borxheve ndaj kreditorëve, është e kufizuar në atë mënyrë që personat fizik të ndërlidhur, gjegjësisht aksionarët, nuk përgjigjen me pasurinë e tyre personale.

Mungesa e trajtimit dhe elaborimit të çështjeve të mësipërme, në mënyrë më të detajuar dhe nga një numër më i madh i njohësve, gjegjësisht ekspertëve, të kësaj lëmie, veçanërisht duke marrë parasysh numrin e madh të shoqërive tregtare ekzistuese në Kosovë, ka qenë motivi kryesor pse kam zgjedhur ta trajtoj pikërisht këtë temë - likuidimin - si punim diplome.

Fjalët kyçe: *likuidimi, falimentimi, objekti i likuidimit, pasuria falimentuese, shoqëria tregtare, debitori, veprimtaria afariste.*